



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Në bazë të nenit 28 dhe nenit 59, paragrafi 10, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Ligji Nr. 03/L-229, data 07 tetor 2010, (gazeta zyrtare Nr. 88/25 nëntor 2010) dhe ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës 16.11.2018 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2018

MBI KRITERET PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË SANKSIONEVE ADMINISTRATIVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI I KËTIJ UDHËZIMI ADMINISTRATIV

Neni 1

1. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret të cilat Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Autoriteti), duhet të merr parasysh në procedurat e përcaktimit të kushteve për shqiptimin e masave administrative dhe gjatë shqiptimit të masave ndëshkuese administrative ndërmarrjeve të cilët kanë shkelur dispozitat e neneve 56 - 58 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (në tekstin e mëtejme Ligji).
2. Qëllimi masave ndëshkuese administrative nga paragrafi 1 i këtij neni, është dënimi (sanksionimi) i kryerësve të shkeljes së Ligjit, eliminimin e efekteve të dëmshme të shkeljes së Ligjit, dekurajimin e ndërmarrësve tjerë nga shkeljet e dispozitave të Ligjit dhe të siguroj konkurrencë efektive në treg.
3. Shuma maksimale e masës ndëshkuese administrative të cilën Autoriteti mund t'ua shqiptoj ndërmarrjes bazuar në këtë udhëzim administrativ për shkelje të dispozitave të Ligjit nuk mund të kalojë shumën e përcaktuar në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit dhe nenit 11 të këtij udhëzimi administrativ.

PËRKUFIZIMET

Neni 2

Për kuptimin e këtij udhëzimi administrativ shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:

- a) **Ndërmarrje** - ka kuptimin sipas nenit 2 të plotësim ndryshimit të Ligjit.
- b) **Masa ndëshkuese administrative** - është masa që i shqiptohet **ndërmarrjes** për të cilin Autoriteti e ka vërtetuar se ka shkelë dispozitat e nenit 56 - 58 të Ligjit.
- c) **Të hyra** - është vlera e shitjes së mallrave dhe/ose shërbimeve që ndërmarrja i ka realizuar vetëm nga kryerja e veprimtarive në tregun përkatës në të cilën Autoriteti ka vërtetuar shkeljen e Ligjit, e në të cilin nuk është i përfshirë tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-ja) as taksat tjera që lidhen direkt me shitjen.
- d) **Tregu relevant** - është tregu i mallrave dhe/ose shërbimeve të caktuara që janë subjekt i aktiviteteve të biznesit të ndërmarrjeve në një zonë të caktuar gjeografike.
- e) **Të hyrat totale të ndërmarrjes** – janë të hyra që një ndërmarrja ka realizuar nga i gjithë aktiviteti ekonomik për të cilin është regjistruar.
- f) **Shuma bazë e masës ndëshkuese administrative** - është pjesa e të hyrave të ndërmarrjes të cekura në pikën c) të këtij neni, e cila varet nga lloji ose pesha e shkeljes së Ligjit e cila shumëzohet me numrin e viteve të shkeljes.
- g) **Kartelet** - në parim janë marrëveshje sekrete horizontale ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura ose vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve ose praktikave e bashkërenduara të ndërmarrjeve të cilët veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit respektivisht të shpërndarjes, dhe synojnë të çrregullojnë konkurrencën ndërmjet konkurrentëve, duke vendosë ndërmjet tyre çmimet e shitjes apo blerjes, ndarjen e tregjeve dhe konsumatorëve, kufizimi i prodhimit dhe/ose shitjes dhe zhvillimit teknologjik, marrëveshjet për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik dhe të ngjashme, dhe si pasojë e marrëveshjeve kartel ka efekt të dëmshëm për konsumatorët në kuptim të rritjes së çmimeve dhe zvogëlimin e zgjedhjes së mallrave dhe/ose shërbimeve.

II. METODOLOGJIA E SHQIPTIMIT TË MASAVE NDËSHKUESE ADMINISTRATIVE SHQIPTIMI I MASAVE NDËSHKUESE ADMINISTRATIVE

Neni 3

1. Me rastin e shqiptimit të masave ndëshkuese administrative Autoriteti, në pajtim me nenin 59, paragrafi 2 i Ligjit aplikon metodologjinë me dy faza për llogaritjen e masave ndëshkuese administrative për secilën ndërmarrje që është vërtetuar se ka bërë shkelje të ligjit.

2. Në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, Autoriteti llogaritë shumën bazë të masës ndëshkuese administrative që konsiderohet hapi i parë i llogaritjes së saj.
3. Shumën bazë të masës ndëshkuese administrative të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti mund ta zvogëlon ose rritë, varësisht nga rrethanat lehtësuese dhe/ose rënduese në procedurë. Zvogëlimi apo rritja e masës ndëshkuese administrative konsiderohet faza e dytë e llogaritjes së masës ndëshkuese administrative.

III. FAZA E (I) - LLOGARITJA E SHUMËS BAZË TË MASËS NDËSHKUESE ADMINISTRATIVE

ELEMENTET E LLOGARITJES SË MASËS NDËSHKUESE ADMINISTRATIVE

Neni 4

1. Shumën bazë të masës ndëshkuese administrative, Autoriteti e llogaritë duke përcaktuar përqindjen e duhur të të hyrave të ndërmarrjeve, ndërsa lartësia e përqindjes varet nga shkalla e shkeljes së Ligjit, dhe shuma që rezulton shumëzohet me numrin e viteve të shkeljes.
2. Autoriteti është i detyruar që në çdo procedurë të përcaktimit të kushteve për vendosjen e masës ndëshkuese administrative ta përcaktoj shkallën e shkeljes së Ligjit, duke marrë parasysh të gjitha faktet relevante dhe rrethanat e rastit konkret.
3. Në parim, përqindja e të hyrave nga paragrafi 1 i këtij neni i cili ka dalë nga llogaritja e shumës bazë për masën ndëshkuese administrative, Autoriteti e përcakton shumën maksimale prej 30% të të hyrave të ndërmarrjes.
4. Gjatë përcaktimit të numrit të viteve të shkeljes nga paragrafi 1 i këtij neni, periudhën më të shkurtë se gjashtë muaj, Autoriteti do të konsiderojë gjysëm viti, ndërsa periudhën më të gjatë se gjashtë muaj, ose më pak se një vit, Autoriteti do ta konsiderojë një vit të plotë të shkeljes së Ligjit.
5. Për të llogaritur shumën bazë të masës ndëshkuese administrative nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti do të vendosë shumëfishin e shumës së 100.00 Euro.

Llogaritja e të hyrave të ndërmarrjes

Neni 5

1. Të hyrat e përcaktuara në nenin 2 paragrafi c, të këtij udhëzimi administrativ konsiderohen të hyrat e përcaktuara në nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ.
2. Autoriteti në parim llogarinë e të hyrave të gjeneruara nga aktiviteti në tregun relevant në të cilën është vërtetuar shkelja e Ligjit, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, do ta bazojë në të dhënat e vlerës së shitjes së mallrave dhe/ose shërbimeve gjatë vitit të fundit financiar, në të cilin ndërmarrja ka shkelur Ligjin, respektivisht viti i fundit për të cilin janë përfunduar

pasqyrat financiare. Në vlerën e shitjeve të mallrave dhe/ose shërbimeve, Autoriteti nuk do të llogaris tatimin mbi vlerën e shtuar, as taksa të tjera që lidhen drejtpërdrejt me shitjen.

3. Nëse Autoriteti vërteton se shoqata e ndërmarrjeve ka shkelur Ligjin, gjatë përcaktimit të shumës bazë të masës ndëshkuese administrative sipas nenit 4, paragrafi 1 të këtij neni, të hyrat e shoqatës së ndërmarrjeve do të konsiderohen si shuma të të hyrave individuale të anëtarëve të saj.
4. Të dhënat për të hyrat nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoritetit detyrimisht do t'ia paraqesë ndërmarrjes i cili është vërtetuar se ka shkelur Ligjin. Nëse Autoriteti konsideron se të dhënat e paraqitura nuk janë të plota ose të pasakta, Autoriteti informatat relevante për të hyrat e ndërmarrjes do t'i përcaktojë në bazë të nenit 38, paragrafi 7 të Ligjit, respektivisht të hyrat e ndërmarrjes do t'i përcaktojë në bazë të të dhënave të pjesshme të mbledhura nga dhe/ose në bazë të çdo informacioni tjetër që konsideron të përshtatshëm.

Përcaktimi i shkallës së shkeljes së Ligjit

Neni 6

1. Për të përcaktuar bazën e duhur të masës ndëshkimore administrative, Autoriteti në përputhje me nenin 4, paragrafi 2 të këtij udhëzimi, në secilin rast veç e veç e përcakton shkallën e shkeljes së Ligjit.
2. Autoriteti, në përputhje me nenin 4 paragrafi 3 të këtij udhëzimi në secilin rast të veçant përcakton nëse përqindja e të hyrave do të jetë në renditjen e sipërme apo të poshtme. Gjatë këtij veprimi Autoriteti është i detyruar të marrë në konsideratë një numër faktorësh për shembull, lloji i shkeljes së ligjit, pjesa e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve në shkelje të ligjit, zonës gjeografike në të cilën shkelja e ligjit ka ose mund të ketë efekt, si dhe shkelja e ligjit është kryer ose ka mbet hapur mundësia e shkeljes së ligjit.
3. Kartelet e përmendura në nenin 2, pika (g) të këtij udhëzimi, do të konsiderohen sipas llojit të tyre format më të rënda të kufizimit të konkurrencës, respektivisht shkeljet më të rënda të ligjit. Në këto raste, Autoriteti pjesën e të hyrave të ndërmarrjeve nga neni 4, pika 3 të këtij udhëzimi do të specifikojë në renditjen e sipërme, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Shuma shtesë për të dekurajuar ndërmarrjet nga shkeljet e Ligjit

Neni 7

1. Në rastet kartel të shkeljeve të ligjit, kur janë marrë vesh për çmimet, ndarjen e tregut dhe kufizimin e prodhimit, pavarësisht nga koha e pjesëmarrjes së ndërmarrësve në shkelje të ligjit, Autoriteti shumë bazë të masës ndëshkuese administrative sipas nenit 4 dhe nenit 6 të këtij udhëzimi administrativ, do ta rritë me një shumë shtesë nga më së shumti në 25% .

2. Qëllimi i rritjes së masës ndëshkuese administrative me shumë shtesë të përmendur sipas paragrafit 1 të këtij neni është për të penguar - dekurajuar ndërmarrjet tjerë për të hyrë në kartelet si format më të rënda të shkeljes së ligjit.
3. Përrjashtimisht, rritja e shumë bazë të masës ndëshkuese administrative nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti mund ta aplikojë edhe në raste të tjera të shkeljes së ligjit, nëse vlerëson se është fjala për rastet konkrete të kufizimit të konsiderueshëm të konkurrencës.

IV. FAZA E (II) - PËRCAKTIMI I RRETHANAVE QË NDIKOJN NË ZBRITJEN APO RRRITJEN E SHUMËS BAZË TË MASËS NDËSHKUESE ADMINISTRATIVE

Rrethanat lehtësuese

Neni 8

1. Shumën bazë të masës ndëshkuese administrative sipas nenit 4 paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti mund të zvogëlojë nëse konstaton ekzistencën e rrethanave lehtësuese.
2. Rrethana lehtësuese nga paragrafi 1 i këtij neni do të konsiderohen në veçanti:
 - a. Dorëzimi i provave në Autoritet nga ndërmarrja për ndërprerjen e aktiviteteve ilegale, menjëherë pas njoftimit të ndërmarrjeve për hetimin paraprak të gjendjes së tregut ose para fillimit të procedurës sipas nenit 36 të Ligjit.
 - b. Dorëzimi i provave në Autoritet nga ndërmarrja që shkelja është pasojë e neglizhencës.
 - c. Dorëzimi i provave në Autoritet nga ndërmarrja se si ai, edhe pse ka marrë pjesë në marrëveshje të ndaluar nuk e ka zbatuar këtë marrëveshje, por ka vepruar në përputhje me rregullat e konkurrencës.
 - d. Bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin në mënyrën dhe masën që tejkalon detyrimet e përcaktuara për zbatimin e lirimimit apo zvogëlimin të masës ndëshkuese administrative sipas nenit 60 të Ligjit.
 - e. Bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin në masën që tejkalon detyrimet e përcaktuara në nenin 38 të Ligjit.
3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2, pika (a) i këtij neni, në rastin e kartelit nga neni 6, paragrafi 3 të këtij udhëzimi, ndërprerja e aktiviteteve të paligjshme nga ana e ndërmarrjes, pas dijës për fillimin e procedurës nga Autoriteti, nuk do të konsiderohet si rrethanë lehtësuese.
4. Autoriteti nuk do ta marrë parasysh si rrethanë lehtësuese nga paragrafi 2 i këtij neni, kohëzgjatjen e shkeljes së ndërmarrjes individuale, sepse kohëzgjatja e shkeljes është një prej elementeve të fazës së parë të llogaritjes së masës ndëshkuese administrative në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të këtij udhëzimi administrativ.

Rrethanat rënduese

Neni 9

1. Shumën bazë të masës ndëshkimore administrative sipas nenit 4 paragrafit 1 të këtij udhëzimi, Autoriteti mund ta rrisë, nëse konstaton ekzistencën e rrethanave rënduese.
2. Rrethana rënduese të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, do të konsiderohen në veçanti:
 - a. Vazhdimi i sjelljes së kundërligjshme të ndërmarrjeve të cilët vazhdojnë me shkeljen e ligjit, edhe pas dorëzimit të mëparshëm të vendimit nga Autoriteti me të cilin konstatohet se veprimet e tilla nga ndërmarrja janë shkelje e ligjit.
 - b. Përsëritja e ngjashme e sjelljes së kundërligjshme nga ndërmarrja i cili vazhdon me shkelje të ligjit, edhe pas dorëzimit të vendimit të mëparshëm nga Autoriteti me të cilin është konstatuar se veprimi i ngjashëm i ndërmarrjes është shkelje e ligjit.
 - c. Refuzimi për të bashkëpunuar me Autoritetin gjatë procedurës.
 - d. Pengimi i Autoritetit në punën e tij gjatë procedurës.
 - e. Roli i iniciatorit ose nxitësit të ndërmarrjeve tjera në shkeljen e ligjit.
 - f. Të gjitha veprimet dhe aktivitetet e ndërmarrura për të siguruar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve tjera në shkeljen e ligjit.
3. Në rast të vazhdimit të njejtë ose përsëritjes së ngjashme të veprimeve të kundërligjshme nga paragrafi 2 (a) dhe (b) të këtij neni, shumën bazë të masës ndëshkuese administrative, Autoriteti do ta rrisë me 100% për çdo rast të përsëritur të shkelësve të identifikuar të ligjit.

Efekti parandalues i masës ndëshkuese administrative

Neni 10

1. Që masa ndëshkuese administrative të ketë efektin parandalues sipas nenit 1 paragrafi 2 të këtij udhëzimi, respektivisht të pengoj ndërmarrjen i cili ka shkelur ligjin si dhe të gjitha ndërmarrjet tjera nga shkelja e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti mund, pavarësisht nga të hyrat të cilat ndërmarrësi i realizon në tregun përkatës në të cilën ka shkelur ligjin, t'ia ngrisë sasinë e masës ndëshkuese administrative asaj ndërmarrje që ka fuqi të ndjeshme tregtare në të paktën dy ose më shumë tregje, respektivisht atij që për të cilin Autoriteti ka konstatuar se arrin të hyra të mëdha nga ushtrimi i të gjitha veprimtarive tregtare për të cilat ajo ndërmarrje është e regjistruar.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti mund të rrisë sasinë e masës ndëshkuese administrative të përcaktuar në fazën e parë dhe të dytë të llogaritur në përputhje me këtë Rregullore, nëse paraqitet nevoja, për konfiskimin e pasurisë të cilën ajo ndërmarrje e ka fituar nga shkelja e ligjit, me kusht që fitimi material mund të vlerësohet (*llogaritet*).

Shuma maksimale e ndëshkimit administrativ

Neni 11

1. Shumën maksimale të masës ndëshkuese administrative që Autoriteti mund t'i shqiptojë një ndërmarrjeje për shkeljen e ligjit, duke marrë parasysh të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, në asnjë rast nuk mund të kalojë shumën më të madhe se 10% të totalit të të hyrave që ndërmarrja ka realizuar nga të gjitha aktivitetet për të cilat është regjistruar në vitin e paraprak, për të cilat janë përfunduar pasqyrat financiare vjetore në kuptim të nenit 59, paragrafi 1 i Ligjit.

Përfundimisht zvogëlimi i masës ndëshkuese administrative për shkak të gjendjes së rëndë financiare të ndërmarrjeve

Neni 12

1. Përfundimisht, me kërkesë të ndërmarrjes që është në një situatë të vështirë financiare dhe nuk është në gjendje të paguajë masën ndëshkuese administrative të përcaktuar me Ligj dhe duke marrë parasysh kriteret në këtë udhëzim, Autoriteti mund të bëjë ulje shtesë në shumën e masës ndëshkuese administrative.
2. Fakti që një ndërmarrje është në gjendje të dobët apo të vështirë financiare nuk është në vetëvete arsye për zvogëlimin e masës ndëshkuese administrative.
3. Përfundimisht, zvogëlimi i masës ndëshkuese administrative sipas paragrafit 1 të këtij neni, Autoriteti mund në raste të jashtëzakonshme t'i lejojë ndërmarrjes i cili me kërkesën për uljen e masës ndëshkuese administrative Autoritetit i dorëzon prova objektive se vendosja e masës ndëshkuese administrative në shumën e përcaktuar me ligj dhe duke i respektuar kriteret e këtij udhëzimi rrezikon qëndrueshmërinë e pa kthyeshme ekonomike të saj duke e çuar në një humbje të plotë të aseteve të saj.

Masat simbolike të ndëshkimit administrativ

Neni 13

1. Në raste të jashtëzakonshme, Autoriteti mund të shqiptojë masa simbolike ndëshkuese administrative.
2. Masën ndëshkuese administrative simbolike të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, Autoriteti mund t'ia shqiptojë një ndërmarrjeje sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje, si dhe në raste të tjera në të cilat Autoriteti ka konstatuar se shtrembërimi i konkurrencës nuk ishte i ndjeshëm, respektivisht nuk ka pasur ndikim të rëndësishëm negativ në treg.
3. Në rastin nga paragrafi 2 i këtij neni, Autoriteti në mënyrë specifike do të theksojë arsyen për shqiptimin e masës ndëshkuese administrative simbolike.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi Administrativ

Neni 14

1. Ndryshimin dhe plotësimin e këtij Udhëzimi Administrativ mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

HYRJA NË FUQI

Neni 15

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS

Valon Prestreshi
Kryetar

Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar

Fatime Haziri
Anëtare

Muhamed Krasniqi
Anëtar

Shaqir Morina
Anëtar